



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, kryegjykatës

Gjykatës Kristof Bart

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 shkurt 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit lidhur me Përdorimin e Deklaratave Të Mëhershme Mospërputhëse sipas Rregullës 143(2)

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të neneve 3, 21, dhe 40(2) dhe 6(h) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 4, 137, 138 dhe 143(2)(c) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 7 nëntor 2023, me kërkesë të Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS"),¹ Trupi Gjykses pranoi si prova dy deklarata të mëhershme të dëshmitarit W03825 në pajtim me rregullën 143(2).² Mbrojtja e Hashim Thaçit ("Mbrojtja e Thaçit") nuk e kundërshtoi pranimin e tyre por vuri në dukje se vazhdonte të kundërshtonte përdorimin, si prova materiale, të pjesëve të deklaratës së mëhershme të një dëshmitari, të pranuar si provë në pajtim me rregullën 143(2), të cilat nuk janë diskutuar me atë dëshmitar gjatë pyetjeve të palës thirrëse.³
2. Më 9 nëntor 2023, Trupi Gjykses e ftoi Mbrojtjen e Thaçit ta konfirmonte dhe ta shpjegonte më tej me shkrim kundërshtimin që kishte lidhur me përdorimin e lejueshëm të deklaratave të pranuar si prova në pajtim me rregullën 143(2).⁴
3. Më 20 nëntor 2023, Mbrojtja e Thaçit dorëzoi parashtrime lidhur me përdorimin e deklaratave të mëhershme mospërputhëse të pranuar si prova në pajtim me rregullën 143(2)(c) ("Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit").⁵

¹ Transkripti i Seancës, 7 nëntor 2023, f. 9509, rreshti 24 deri f. 9510, rreshti 16.

² Transkripti i Seancës, 7 nëntor 2023, f. 9511, rreshti 21 deri f. 9512, rreshti 1.

³ Transkripti i Seancës, 7 nëntor 2023, f. 9510, rreshti 19 deri f. 9511, rreshti 5.

⁴ Transkripti i Seancës, 9 nëntor 2023, f. 9705, rreshti 24 deri f. 9706, rreshti 1.

⁵ F01940, Mbrojtësi i Specializuar, *Parashtrime të Mbrojtjes së Thaçit lidhur me Përdorimin e Deklaratave të Mëhershme Mospërputhëse sipas Rregullës 143(2)(c)*, 20 nëntor 2023.

4. Më 27 nëntor 2023, ZPS-ja iu përgjigj Parashtrimeve të Mbrojtjes së Thaçit (“Përgjigja”).⁶

5. Më 1 dhjetor 2023, pas miratimit të lejes për kundërpërgjigje nga Trupi Gjykses,⁷ Mbrojtja e Thaçit iu kundërpërgjigj Përgjigjes (“Kundërpërgjigja”).⁸

6. Më 1 shkurt 2024, Mbrojtja e Thaçit i kërkoi Trupit Gjykses të jepte udhëzime mbi mënyrën si e interpretonte rregullën 143.⁹ Mbrojtja e z. Selimi dhe Mbrojtja e z. Krasniqi e mbështetën këtë kërkesë.¹⁰

II. PARASHTRIMET

7. Mbrojtja e Thaçit parashtron se Trupi Gjykses mund të pranojë si prova dhe të mbështetet vetëm në pjesët e deklaratës së një dëshmitari, të pranuar në pajtim me rregullën 143(2)(c), të cilat janë diskutuar me këtë dëshmitar gjatë dëshmisë gojore, dhe të cilat nuk përputhen me këtë dëshmi gojore.¹¹ Mbrojtja e Thaçit argumenton se: (i) me “deklaratë të mëhershme mospërputhëse”, term që nuk përkufizohet nga Rregullorja, duhet kuptuar një pohim apo paraqitje mospërputhëse e mëhershme, dhe jo një deklaratë dëshmitari mospërputhëse; dhe (ii) jurisprudenca ndërkombëtare dhe vendore e kufizon përdorimin e pjesëve të deklaratës së një dëshmitari të cilat nuk janë diskutuar me të dhe të cilat nuk përmbushin kriteret e rregullave 153-155.¹² Në mbështetje të këtij pretendimi,

⁶ F01962, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Mbrojtjes së Thaçit mbi Rregullën 143(2)(c)*, 27 nëntor 2023.

⁷ F01974, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Kundërpërgjigje ndaj F01962-shit*, 1 dhjetor 2023.

⁸ F01978, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Mbrojtjes së Thaçit mbi Rregullën 143(2)(c)*, 1 dhjetor 2023.

⁹ Transkripti i Seancës, 1 shkurt 2024, f. 12497, rreshtat 10 deri 17.

¹⁰ Transkripti i Seancës, 1 shkurt 2024, f. 12497, rreshtat 18 deri 23.

¹¹ Kërkesa, para. 3, 22.

¹² Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 7-13, 16, 22 që i referohen Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“TPNJ”), Prokurori kundër Fatmir Limajt e Të Tjerëve, IT-03-66-T, Trial Chamber II, [Decision on the Prosecution’s Motions to Admit Prior Statements as Substantive Evidence](#) (Vendim mbi Mocionet e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të Mëparshme si Prova Thelbësore) (“Vendimi Limaj”), 25 prill 2005, para. 18-19; United States, Federal Rules of Evidence, as amended on

Mbrojtja e Thaçit sugjeron se janë veçanërisht relevantë precedentët e juridiksioneve anglosaksone nga të cilat buron ky term,¹³ dhe se ky qëndrim është konfirmuar edhe nga precedentët e Gjykatës Penale Ndërkombëtare (“GJPN”).¹⁴

8. ZPS-ja përgjigjet se Trupi Gjykues duhet t’i hedhë poshtë Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit dhe se, në përputhje me formulimin e rregullës 143(2)(c), duhet t’i pranojë deklaratat sipas kësaj rregulle për vlerësimin e besueshmërisë, vërtetësinë e përmbajtjes së tyre ose për qëllime të tjera sipas gjykimit të Trupit Gjykues.¹⁵ ZPS-ja argumenton se Mbrojtja e Thaçit kërkon të mbështetet në disa çështje gjyqësore të përzgjedhura nga e drejta anglosaksone, të bazuara në rregulla përjashtuese lidhur me informacionet e dorës së dytë, që nuk janë të zbatueshme për Dhomat e Specializuara në të cilat gjykimi i fakteve bëhet nga gjykatës profesionistë dhe jo nga juria.¹⁶ ZPS-ja pretendon se, në kundërshtim me Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, tribunalët ndërkombëtarë janë distancuar nga qëndrimi i së drejtës anglosaksone lidhur me informacionin e dorës së dytë dhe

1 December 2020, Rule 801(a) and (d)(1)(A); Australia, Evidence Act 1977 (Queensland), as amended on 1 August 2023, Section 101(1) and Schedule 3; Australia, Evidence Act 1995 (Commonwealth), as amended on 1 May 2016, Section 60(1); United Kingdom, Criminal Justice Act 2003, as amended on 1 shkurt 2015, Sections 115 and 119.

¹³ Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 14-15 që i referohen United States, *People v. Lawrence*, No. 1-93-2767, Appellate Court of Illinois (First District, Fifth Division), 18 November 1994; *United States v. Finch*, No. 19-0298, Court of Appeals for the Armed Forces, 3 March 2020, pf. 14-15.

¹⁴ Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 17-21 që i referohen International Criminal Court (“ICC”), *Prosecutor v. Alfred Yekatom and Patrice-Edouard Ngaïssona*, ICC-01/14-01/18-1659, Trial Chamber V, [Decision on the Yekatom Defence Motion for Directions Regarding Reliance on Prior Recorded Testimonies for Non-Rule 68\(3\) Witnesses](#) (“Yekatom Decision”), 9 November 2022, para. 5, fn. 7; *Prosecutor v. Germain Katanga and Mathieu Ngudjolo Chui*, ICC-01/04-01/07-2954, Trial Chamber II, [Decision on Defence Request to Admit into Evidence Entirety of Document DRC-OTP-1017-0572](#) (“Katanga Decision”), 25 May 2011, paras 1-4, 7; *Prosecutor v. William Samoei Ruto and Joshua Arap Sang*, ICC-01/09-01/11-1938-Corr-Red2, Trial Chamber V(A), [Decision on Prosecution Request for Admission of Prior Recorded Testimony](#), (“Ruto Decision”), 19 August 2015; ICC-01/09-01/11-1938-Anx-Red, Trial Chamber V(A), [Separate, Partly Concurring Opinion of Judge Eboe-Osuji on the ‘Decision on Prosecution Request for Admission of Prior Recorded Testimony’](#), 19 August 2015, para. 48; ICC-01/09-01/11-2024, Appeals Chamber, [Judgment on the appeals of Mr William Samoei Ruto and Mr Joshua Arap Sang against the decision of Trial Chamber V\(A\) of 19 August 2015 entitled “Decision on Prosecution Request for Admission of Prior Recorded Testimony”](#), (“Ruto Judgement”), 12 February 2016; ICTY, *Prosecutor v. Sefer Halilović*, IT-01-48-T, Trial Chamber I(A), [Decision on Admission into Evidence of Prior Statement of a Witness](#) (“Halilović Decision”), 5 July 2005.

¹⁵ Përgjigja, para. 1, 10.

¹⁶ Përgjigja, para. 2-3.

pranimin e kufizuar të tij si provë; jurisprudenca e tribunalëve ndërkombëtarë, veçanërisht e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“TPNJ”), është kodifikuar në rregullën 143(2)(c).¹⁷ Së fundi, ZPS-ja parashtron se precedentët e GJPN-së, në të cilët mbështetet Mbrojtja, janë krijuar në kuadrin ligjor specifik të GJPN-së, në të cilin nuk ekziston një rregull e barasvlershme me rregullën 143(2) dhe, gjithsesi, nuk mbështetin qëndrimin e Mbrojtjes së Thaçit.¹⁸

9. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se rregulla 143(2)(c) e bën të qartë se një palë mund t’i bëjë pyetje një dëshmitari lidhur me një “deklaratë të mëhershme mospërputhëse” dhe se një deklaratë “e tillë” e mëhershme mospërputhëse mund të jetë e pranueshme si provë.¹⁹ Mbrojtja e Thaçit parashtron se fjala “e tillë” i referohet deklaratës së mëhershme mospërputhëse që diskutohet në fjalinë e parë, konkretisht një deklaratë të mëhershme mospërputhëse për të cilën ka bërë “pyetje” një palë e procesit gjyqësor.²⁰ Rrjedhimisht, ajo argumenton se si provë mund të pranohet vetëm një pohim apo paraqitje mospërputhëse e mëhershme për të cilën është pyetur dëshmitari, dhe jo e gjithë deklarata e mëhershme e dëshmitarit, që përmban pohime apo paraqitje të tilla të mëhershme mospërputhëse.²¹ Në fund, Mbrojtja e Thaçit vëren se nuk ka sugjeruar asnjëherë se zbatohet rregulla e informacioneve përjashtuese të dorës së dytë, por se parimi i dëshmisë gojore nuk i lejon Trupit Gjyqësor të pranojë dëshmi të mëhershme për të cilat nuk është pyetur dëshmitari në pajtim me kriteret e rregullës 143(2)(c).²²

¹⁷ Përgjigjja, para. 3, 5 që i referohet [Vendimit Limaj](#), para. 16-18; ICTY, *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-AR73.3, Appeals Chamber, [Decision on Appeals against Decision on Impeachment of a Party’s Own Witness](#) (“Popović Decision”), 1 February 2008, para. 32.

¹⁸ Përgjigjja, para. 6 që i referohet [Ruto Decision](#), para. 73-74.

¹⁹ Kundërpërgjigjja, para. 1-3.

²⁰ Kundërpërgjigjja, para. 3.

²¹ Kundërpërgjigjja, para. 3.

²² Kundërpërgjigjja, para. 5.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Në pajtim me nenin 40(6)(h), Trupi Gjykses mund të vendosë për pranueshmërinë e provave para ose gjatë gjykimit. Në pajtim me rregullën 138(1), në rast se nuk janë kundërshtuar ose përjashtuar *proprio motu*, provat e paraqitura para trupit gjykses pranohen vetëm në qoftë se kanë lidhje me lëndën, kanë vlerë provuese dhe vlera provuese e tyre nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.

11. Në pajtim me rregullën 143(1), dhe në varësi të përjashtimeve të përcaktuara në Rregullore, parimisht dëshmitarët e japin dëshminë e tyre në gjyq duke qenë të pranishëm. Me lejen e Trupit Gjykses dhe kur është relevante për sa i përket besueshmërisë së dëshmitarit, pala që ka thirrur dëshmitarin mund ta pyesë atë lidhur me faktin nëse ky dëshmitar ka dhënë në çfarëdo kohe deklaratë të mëhershme mospërputhëse sipas rregullës 143(2). Çdo deklaratë e tillë mospërputhëse mund të jetë e pranueshme për vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarit si edhe vërtetësinë e përmbajtjes së saj, ose për qëllime të tjera sipas gjykimit të trupit gjykses.²³

IV. DISKUTIM

12. Në pajtim me rregullën 143(2)(c), Trupi Gjykses ka pranuar si prova deklaratat e mëhershme mospërputhëse të dëshmitarëve të ZPS-së W03827, W04746 dhe W03825, në tërësinë e tyre ose pjesërisht.²⁴

13. Pyetja që shtrohet tani para Trupit Gjykses, lidhur me të cilën kërkon udhëzime Mbrojtja, është nëse Trupi Gjykses mund të mbështetet vetëm në ato

²³ Rregulla 143(2)(c). *Shih gjithashtu F01226/A01, Trupi Gjykses, Shtojca 1 e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit, 25 janar 2023, para. 106-107.*

²⁴ F01821, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të Dëshmitarit W03827 sipas Rregullës 143(2) dhe Kërkesën e Mbrojtjes për Rishikim* ("Vendimi mbi Pranimin e Deklaratave të W03827-s sipas Rregullës 143(2)"), 28 shtator 2023, para. 37-51; F01903, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Pranim të Materialeve të Përdorura Gjatë Marrjes në Pyetje të W04746-ës* ("Vendimi mbi Pranimin e Materialeve të Përdorura gjatë Marrjes në Pyetje të W04746-ës"), 3 nëntor 2023, para. 22; Transkripti i Seancës, 7 nëntor 2023, f. 9511, rreshti 21 deri f. 9512, rreshti 1.

pjesë të deklaratës së një dëshmitari, që është pranuar si provë në pajtim me rregullën 143(2)(c), për të cilat dëshmitari është pyetur gjatë dëshmisë gojore, dhe që thuhet apo është provuar se nuk përputhen me atë dëshmi gojore, apo nëse Trupi Gjykses mund të mbështetet në deklaratën e dëshmitarit në tërësi.²⁵ Zakonisht, Trupi Gjykses nuk pranon të japë vendim këshillimor. Megjithëkëtë, në rastin konkret, Trupi Gjykses konsideron se është e drejtë që të japë udhëzime mbi një aspekt që mund të ndikojë edhe lidhur me mënyrën e paraqitjes së provave nga palët edhe mbi mënyrën si e kuptojnë ato se cilat prova janë relevante për përgjegjësinë që ka Trupi Gjykses për gjykimin e fakteve.

14. Fillimisht, Trupi Gjykses rikujton se e ka shqyrtuar dhe hedhur poshtë argumentin e Mbrojtjes së Thaçit se rregullat 153-155 janë *leges speciales* të rregullës 143(2).²⁶ Trupi Gjykses rithekson se dy llojet e dispozitave mbulojnë rrethana të ndryshme në të cilat mund të pranohen si prova deklaratat e dëshmitarëve.²⁷

15. Sa i përket argumentit të Mbrojtjes së Thaçit se termi “deklaratë e mëhershme mospërputhëse” në rregullën 143(2)(c) i referohet një “pohimi” apo “paraqitjeje” të mëhershme mospërputhëse, dhe jo deklaratës së mëhershme të një dëshmitari në tërësi,²⁸ Trupi Gjykses vëren se fjala “deklaratë” nuk përkufizohet shprehimisht në Rregullore por përdoret në disa dispozita të pjesës III, kryesisht në rregullat 153-155. Më parë, Trupi Gjykses ka sqaruar se “deklaratë me shkrim” ose “deklaratë”, në kuadrin e rregullave 153-155, është një dokument në çfarëdo formë e asaj që ka thënë një dëshmitar lidhur me faktet dhe rrethanat relevante të një çështjeje gjyqësore, dhënë në kontekstin e një hetimi ose procesi penal.²⁹ Nuk

²⁵ Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 3.

²⁶ *Shih* Vendimin mbi Pranimin e Deklaratave të W03827-ës në Pajtim me Rregullën 143(2), para. 21-27.

²⁷ *Po aty*.

²⁸ Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 7-11.

²⁹ Sa i përket përkufizimit se çfarë përbën “deklaratë” për të vendosur mbi pranimin e provave, *shih p.sh.* F01963, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Pranimin e Dokumenteve të Treguara W04769-ës*, 27 nëntor 2023, para. 15, poshtëshënimi. 35; F01852, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Krasniqit për Pranimin e Dokumentit Shtesë në Lidhje me W02153-shin*, 11 tetor 2023, para. 8; F01380, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Pranimin e Provave të Dymbëdhjetë Dëshmitarëve të Parë të ZPS-së sipas Rregullës 154* (“Vendimi i Parë sipas Rregullës 154”), 16 mars 2023, konfidencial, para. 12, 26 (versioni i redaktuar publik u

ekziston asnjë tregues se synohej që fjala “deklaratë” në rregullën 143(2)(c) të kishte një kuptim të ndryshëm dhe më të ngushtë se ai i rregullave 153-155. Përkundrazi, përdorimi i së njëjtës terminologji dikton që në rastet kur dispozitat e tjera u referohen “deklaratave” (me shkrim), synimi ishte që kuptimi të ishte i njëjtë dhe i pandryshueshëm se përndryshe do të ishin përdorur formulime të tjera si për shembull “pohime” ose “paraqitje”. Po kështu, interpretimi i parashtruar nga Mbrojtja e Thaçit do të krijonte rrethana në të cilat Trupit Gjykses do t’i lejohej të konsideronte si prova më pak (d.m.th., “pohimet” ose “paraqitjet” mospërputhëse) se çfarë është pranuar (d.m.th., të gjithë deklaratën e një dëshmitari). Rregullorja nuk përmban ndonjë rregull apo parim që t’i kufizojë Trupit Gjykses mundësinë të mbështetet në çfarëdo prove për të cilën ka konstatuar se është e pranueshme për realizimin e funksionit të tij për gjykimin e fakteve.

16. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se ndonëse *marrja në pyetje* lidhur me një deklaratë të mëhershme mospërputhëse kufizohet në aspekte të besueshmërisë (paragrafi hyrës i rregullës 143(2)), *pranimi* i një deklaratë të tillë rregullohet përmes rregullës 143(2)(c), fjalia e dytë, e cila nuk kufizohet në aspekte të besueshmërisë së dëshmitarit për të cilën është pyetur ai, por mund të pranohet edhe për vërtetësinë e përmbajtjes së saj, ose për qëllime të tjera sipas gjykimit të trupit gjykses.

17. Rrjedhimisht, leximi fjalë për fjalë dhe sistematik i Rregullores të çon në përfundimin se fjala “deklaratë” në rregullën 143(2)(c) i referohet të gjithë deklaratës në fjalë (dhe/ose pjesëve të paraqitura për t’u pranuar si provë në rast se ajo nuk është paraqitur në tërësi) dhe jo pretendimeve, thënieve apo

lëshua më 7 nëntor 2023, F01380/RED). *Shih gjithashtu* F01700, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave nga* W03724, W03832, W03880, W04368, W04566, dhe W04769 sipas Rregullës 154, 24 korrik 2023, konfidencial, para. 68 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 7 nëntor 2023, F01700/RED); KSC-BC-2020-07, F00334, Trupi Gjykses, *Vendim në lidhje me Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 29 shtator 2021, para. 84-87.

propozimeve individuale që ajo përmban të cilat janë diskutuar me një dëshmitar për shkak të mospërputhjes.

18. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se një interpretim të tillë duket se e mbështet edhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në të cilin, kur diskutohet ndryshimi i rregullës 143(2)(c), u referohet “deklaratave të dhëna nga i njëjti dëshmitar gjatë proceseve penale”.³⁰ Ky interpretim përputhet tërësisht edhe me parimin e dëshmive gojore, për të cilin Trupi Gjykses ka konstatuar se nuk është absolut, por i kufizuar nga disa dispozita, përfshirë rregullën 143(2)(c).³¹

19. Së fundi, Trupi Gjykses nuk bindet lidhur me relevancën e jurisprudencës së juridiksioneve anglosaksone, apo të GJPN-së, në të cilat mbështetet Mbrojtja e Thaçit.³² Së pari, Trupi Gjykses kryesisht udhëhiqet nga Ligji dhe Rregullorja dhe në interpretimin që jurisprudenca ndërkombëtare dhe ligjet e Kosovës u kanë bërë këtyre instrumenteve.³³ Rrjedhimisht, disa shembuj të përzgjedhur nga juridiksionet anglosaksone parimisht nuk janë relevantë nga pikëpamja normative për interpretimin e Rregullores, sidomos për shkakun se ato nuk pasqyrojnë qasjen e përgjithshme për këtë aspekt. Në këtë drejtim, Trupi Gjykses vëren se TPNJ-ja, në të cilin mbështetet Mbrojtja për të sugjeruar se koncepti i “deklaratave të mëhershme mospërputhëse” buron nga e drejta anglosaksone, nuk e ka miratuar kuptimin e kufizuar të këtij nocioni sikurse parashtron Mbrojtja e Thaçit. Përkundrazi, në rastet kur janë pranuar deklarata të mëhershme mospërputhëse, TPNJ-ja nuk e ka kufizuar përdorimin e lejuar të tyre vetëm për pjesët të cilat janë diskutuar me dëshmitarët për shkak të mospërputhjes.³⁴ Së dyti, sa u përket

³⁰ KSC-CC-PR-2020-09/F00006, Gjykata Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020*, 26 maj 2020, para. 80.

³¹ *Shih* F01250, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Ruajtjen e Provave*, 2 shkurt 2023, para. 30-31; Vendimi i Parë sipas Rregullës 154, para. 18 (me referencat shtesë); *Shih gjithashtu Vendimin Limaj*, para. 29-30.

³² Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 7-21.

³³ Neni 3(2)-(4).

³⁴ *Shih p.sh., Vendimin Limaj* (në të cilin trupi gjykses pranoi dy incizime me video të intervistave të mëhershme mospërputhëse të dy dëshmitarëve si prova); ICTY, *Prosecutor v. Goran Hadžić*, IT-05-75-T,

vendimeve të GJPN-së në të cilat mbështetet Mbrojtja e Thaçit, Trupi Gjykses vëren se në GJPN nuk ekziston një dispozitë e ngjashme apo e krahasueshme me rregullën 143(2)(c). Rrjedhimisht, në rastin më të mirë, jurisprudenca e GJPN-së do të kishte relevancë të kufizuar sa i përket aspektit aktual.³⁵ Gjithashtu, jurisprudenca e GJPN-së së cilës i referohet Mbrojtja e Thaçit nuk duket se tregon se ky nocion është kuptuar gjithnjë njësoj dhe, në rastin më të mirë, është pasqyrim i jurisprudencave mospërputhëse mbi këtë pikë dhe/ose i qasjeve të ndryshme ndaj mënyrës së ushtrimit të diskrecionit nga ana e trupave gjykses (dhe gjykatësve) të ndryshëm të GJPN-së.³⁶

Trial Chamber, [Decision on Defence Submissions in Support of Admission of Prior Inconsistent Statements of a Witness for Purpose of Impeachment](#), 6 May 2013, paras 7-8 (në të cilin trupi gjykses rikujtoi konstatimin e dhomës së apelit se deklaratat e mëhershme mospërputhëse mund të pranoheshin si dëshmi të dorës së dytë për shkak të vërtetësisë së përmbajtjes së tyre, se i takonte trupit gjykses të vendoste mbi pranimin e një deklaratë të mëhershme mospërputhëse si provë dhe të arrinte në përfundimin se për të shmangur mbingarkesën që rrjedh nga pranimi i materialeve të tepërta, mjaftonte marrja në pyetje e dëshmitares për të vlerësuar besueshmërinë e saj); *Shih gjithashtu Popović Decision*, para. 31-32 (në të cilin dhoma e apelit konstatoi se përmbajtja e një deklaratë të mëhershme mospërputhëse mund të pranohet si dëshmi e dorës së dytë për shkak të vërtetësisë së përmbajtjes së saj kur plotësohen kriteret e rregullores së Tribunalit që ajo të ketë lidhje me lëndën dhe të jetë aq e besueshme sa të pranohet se ka vlerë provuese).

³⁵ *Shih gjithashtu* Vendimin mbi Pranimin e Deklaratave të W03827-ës në Pajtim me Rregullën 143(2), para. 36.

³⁶ Në vendimet *Yekatom* dhe *Katanaga*, trupat gjykses përkatës vunë në dukje se deklaratat e mëhershme (mospërputhëse) nuk do të pranoheshin si prova por në dokumentacionin e gjykimit do të shënohej se i ishin treguar apo lexuar dëshmitarit, ndërsa në Vendimin *Ruto*, trupi gjykses i pranoi në tërësi dëshmitë e regjistruara të mëhershme. *Shih Yekatom Decision*, para. 1, 5-7 (në të cilin trupi gjykses e hodhi poshtë kërkesën e mbrojtjes për udhëzime të hollësishme lidhur me deklaratat e mëhershme, përfshirë ato që nuk përputheshin me dëshmitë gojore, dhe përsëriti se dëshmitë e dokumentuara të mëhershme (jo dëshmitë mospërputhëse të dokumentuara të mëhershme) do të merreshin parasysh për kuvendimet mbi aktgjykimin në rastet kur trupi gjykses lejonte përdorimin e tyre, dhe vetëm për sa u përkonte pjesëve të kufizuara të cilat ishin bërë pjesë e dokumentacionit të çështjes gjyqësore pasi i ishin lexuar dhe/ose treguar dëshmitarit); *Katanga Decision*, para. 1-2, 4, 6-7 (në të cilin trupi gjykses pranoi si provë një pjesë të një dëshmie të dokumentuar të mëhershme, e cila ishte diskutuar me dëshmitarin për shkak të mospërputhjeve, por hodhi poshtë kërkesën për pranimin në tërësi të një deklaratë të mëhershme mospërputhëse, duke vërejtur se pjesa në fjalë ishte pranuar si provë sepse ishte lexuar me zë të lartë dhe se praktika e njohur ishte që të mos pranoheshin si prova deklaratat e dokumentuara të mëhershme të dëshmitarëve që jepnin dëshmi në sallën e gjyqit); *Ruto Decision*, para. 151 (në të cilin trupi gjykses, me shumicë votash, i pranoi deklaratat e dokumentuara të mëhershme të dëshmitarëve në tërësi për shkak të vërtetësisë së përmbajtjes së tyre); *Ruto Judgment*, para. 95-96, 98 (në të cilin dhoma e apelit e përmbysi Vendimin *Ruto* për pranimin si prova të dëshmimeve të dokumentuara të mëhershme në tërësi për shkak të vërtetësisë së përmbajtjes së tyre, mbi bazën se rregulla 68 e ndryshuar e Rregullores së GJPN-së ishte ndryshuar pas fillimit të gjykimit të asaj çështjeje penale, dhe se ishte

20. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses përsërit se rregulla 143(2)(c) nuk kërkon që pala thirrëse t'i lexojë një dëshmitari të gjithë deklaratën që thuhet se përmban mospërputhje.³⁷ Përkundrazi, rregulla 143(2)(c) i kërkon palës thirrëse që thjesht të verifikojë se deklaratat që paraqitet për pranim si provë "përputhet" me dëshminë gojore të dëshmitarit. Në rastin kur deklaratat e mëhershme mospërputhëse përmbush kriteret e rregullave 138 dhe 143(2)(c), atëherë i takon Trupit Gjykses të vendosë ta pranojë deklaratën e mëhershme mospërputhëse në tërësi, ose pjesërisht, ose t'i kërkojë palës që ka thirrur dëshmitarin të lexojë vetëm disa pjesë për përfshirjen e tyre në dokumentacionin e gjykimit,³⁸ dhe arsyen/arsyet për një gjë të tillë.³⁹ Megjithatë, për këtë vlerësim, Trupi Gjykses vëren se merret në konsideratë fakti nëse pala që e ka thirrur dëshmitarin i ka dhënë këtij dëshmitari mundësinë të shpjegojë, ose mohojë, çdo mospërputhje të pretenduar ndërmjet deklaratës së tij dhe dëshmisë së dhënë në sallën e gjyqit.⁴⁰

21. Në fund të fundit, i takon Trupit Gjykses të përcaktojë nëse do t'u japë peshë deklaratave të mëhershme mospërputhëse të një dëshmitari që pranohen si prova

zbatuar në mënyrë prapavepruese duke cenuar të akuzuarin); *Shih gjithashtu* Vendimin mbi Pranimin e Deklaratave të W03827-s në Pajtim me Rregullën 143(2), para. 36.

³⁷ Vendimi mbi Pranimin e Materialeve të Përdorura gjatë Marrjes në Pyetje të W04746-ës, para. 22.

³⁸ *Shih për shembull më lart*, poshtëshënimin. 34; *Shih gjithashtu* International Criminal Tribunal for Rwanda, *Prosecutor v. Jean-Baptiste Gatete*, ICTR-2000-61-T, Trial Chamber III, [Decision on Defence Motion to Admit MFI/3 into Evidence Pursuant to Rule 89\(C\) of the Rules of Procedure and Evidence](#), 15 December 2009, para. 2, 6 (në të cilin trupi gjykses hodhi poshtë një kërkesë për pranimin si provë të një deklarate *pro-justitia*, që pretendohet se ishte nënshkruar nga dëshmitari, duke nënvizuar se, në pajtim me rregullën 89(C), kishte diskrecion për ta pranuar dokumentin në fjalë por se mbrojtja nuk kishte arritur t'i provonte treguesit e besueshmërisë në mënyrë të mjaftueshme); *Shih gjithashtu* Vendimin mbi Pranimin e Materialeve të Përdorura gjatë Marrjes në Pyetje të W04746-ës, para. 22 (ku është ushtruar diskrecioni për të pranuar si prova disa pjesë të deklaratave të mëhershme të W04746-ës për të cilat ishte marrë në pyetje dëshmitari në sallën e gjyqit, si dhe pjesët shtesë që ishin të domosdoshme për të kuptuar kontekstin e tyre).

³⁹ Trupi Gjykses vëren se rregulla 143(2)(c) i jep diskrecion të gjerë për pranimin e deklaratave të mëhershme mospërputhëse si prova, formulimi i rregullës është se ai mund ta pranojë një deklaratë të tillë si provë "për vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarit, si dhe për vërtetësinë e përmbajtjes së saj ose për qëllime të tjera sipas diskrecionit të Trupit Gjykses".

⁴⁰ *Shih për shembull*, [Vendimin Limaj](#), para. 23 (në të cilin trupi gjykses mori parasysh se pjesët relevante të incizimeve përkatëse me video ishin luajtur në sallën e gjyqit përpara pranimin si prova të dy incizimeve me video); [Halilović Decision](#), p. 5 (në të cilin trupi gjykses nuk pranoi si provë deklaratën e mëhershme të një dëshmitari për shkak se prokuroria, ndër të tjera, nuk i bëri atij pyetje lidhur me pjesët përkatëse të deklaratës së mëhershme të tij).

në pajtim me rregullën 143(2)(c), dhe sa peshë t'u japë, mbi bazën e dëshmisë gojore të dëshmitarit, përfshirë edhe çdo shpjegimi që jepet lidhur me mospërputhjen,⁴¹ dhe çdo prove tjetër relevante.

V. VENDIM

22. Për këto arsye, Trupi Gjykses,

(a) **HEDH POSHTË** Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit; dhe

(b) **SQARON**, për palët, se Trupi Gjykses mund ta pranojë një deklaratë të mëhershme mospërputhëse të një dëshmitari në pajtim me rregullën 143(2)(c) në tërësi apo pjesërisht dhe, për realizimin e përgjegjësisë së tij për gjykimin e fakteve, mund të mbështetet në çdo pjesë të deklaratës së pranuar si provë, pa u kufizuar në pjesën, apo pjesët, e deklaratës të cilat janë diskutuar me dëshmitarin në sallën e gjyqit gjatë dëshmisë së tij gojore për shkak të mospërputhjes.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

⁴¹ *Shih për shembull*, ICTY, *Prosecutor v. Popović et al.*, No. IT-05-88-A, [Judgement](#), 30 January 2015, para. 136 (në të cilin dhoma e apelit konstatoi se trupi gjykses duhet të marrë parasysh çdo shpjegim të ofruar lidhur me mospërputhjet gjatë përcaktimit të vlerës provuese të një dëshmie); *Prokurori kundër Limajt e Të Tjerëve*, No. IT-03-66-T, [Judgement \(Aktgjykimi\)](#), 30 nëntor 2005, para. 14 (në të cilin trupi gjykses, pavarësisht se nuk ishte mbështetur në intervistat e mëhershme të incizuara me video të dy dëshmitarëve të prokurorisë, të cilët shfaqën mospërputhje materiale me dëshmitë e tyre gojore në gjyq dhe ishin pranuar si prova materiale, vuri në dukje se deklaratat e mëhershme mospërputhëse mund të kenë ndonjë forcë vërtetuese, të paktën nëse ato mbështesin dëshmi të tjera në dukje të besueshme të dëshmitarëve të tjerë gjatë procesit); *Prosecutor v. Lukić et al.*, No. IT-98-32/1-A, [Judgement](#) (në të cilin dhoma e apelit konstatoi se përgjithësisht dëshmia gojore ishte më e besueshme se deklaratat e mëhershme dhe se, në rastet kur trupi gjykses preferonte më shumë deklaratën e mëhershme të një dëshmitari përkundër dëshmisë së tij apo të saj gojore, atëherë duhet të paraqesë arsyet për një vendim të tillë), 4 dhjetor 2012, para. 614.

E enjte, 15 shkurt 2024

Në Hagë, Holandë.